Principe të Programimit në Java: Arkitekturat dhe Interfejsat

Ushtrime
(Pjesa e dytë: kapitujt VII-VIII)

nga David Schmidt me Ridvan Bunjakun



Gjilan
2005

Përmbajtja

Hyrje

Në këtë tekst janë përkthyer dhe përshtatur ushtrimet nga kapitujt VII-VIII të librit të David Schmidt: "Programming Principles in Java: Architectures and Interfaces", që mund ta gjeni në www.cis.ksu.edu/santos/schmidt/ppj. Ky është vazhdimi i librit të parë ku janë ushtrimet nga kapitujt I-VI. E falënderoj autorin për lejimin e publikimit të këtij teksti.
Libri i Schmidt-it është i mrekullueshëm për fillestarët në programim dhe konkretisht në Java. Me anë të shembujve praktikë e shumë të afërt me cilindo lexues, autori e bën të këndshëm mësimin e Java-s dhe të teknikave të ndryshme të programimit.
Motivi për shkruarjen e këtij teksti në gjuhën shqipe lindi gjatë punës me studentë të cilët nuk e zotëronin mirë gjuhën angleze. Për shkak të pengesës së gjuhës ata nuk mund ta lexonin librin dhe t'i kuptonin kodet e ndryshme. Përshtatja ime e kodit në gjuhën shqipe (në masën sa është e mundur) doli të jetë e dobishme për ta.
Natyrisht, parapëlqehet që ky tekst të përdoret krahas librit të Schmidt-it. Poashtu, informata të dobishme mund të mirren edhe nga ueb-faqja e prof. Faton Berisha: fberisha.netfirms.com.

Për kë është ky tekst?

Ky tekst është shkruar për studentët që i ndjekin ushtrimet nga "Strukturat e të dhënave" në Universitetin e Prishtinës, FSHMN, Departamenti i Matematikës, Drejtimi i Shkencës Kompjuterike. Mirëpo mund ta përdorin si tekst për ushtrime të gjithë ata që duan ta mësojnë gjuhën Java bashkë me disa teknika bashkëkohore të programimit dhe filozofinë e programimit të orientuar kah objektet.

Gjuha e përdorur në tekst

Ky tekst nuk e ka për qëllim shmangien e mësimit të gjuhës angleze, por mësimin thelbësor të gjërave. Gjuha angleze, në të vërtetë, është kusht i domosdoshëm për Shkencën Kompjuterike.
I mirëpres të gjitha vërejtjet, këshillat dhe komentet rreth tekstit.

Ridvan Bunjaku, ing. mat.
ridvan.bunjaku@fshmn.uni-pr.edu

VII Shabllonat e Përsëritjeve: Iterimi dhe Rekursioni

(7.1 Përsëritja)

7.2 Urdhëri `while`

1. Çka do të afishojnë këto cikle-while ?

a.

```
String s = "";
while ( s.length() != 5 )
      { s = s + 'a';
        System.out.println(s);
      }
```

(Rikujto se veprimi `length` e kthen gjatësinë e stringut; për shembull,

```
 String s = "abcde";
 int i = s.length();
```

ia ndan vlerën 5 ndryshores `i`.)

Përgjigje:

```
a
aa
aaa
aaaa
aaaaa
```

b.

```
int teposhte = 10; // countdown
while ( teposhte != 0 )
      { System.out.println(i);
        teposhte = teposhte – 1;
      }
```

Përgjigje:

Ky kod i afishon numrat e plotë prej 10 deri në 1.

c.

```
int teposhte = 5;
int perpjete = -1; // countup
while ( teposhte > perpjete )
      { teposhte = teposhte - 1;
        System.out.println(teposhte + " " + perpjete);
        perpjete = perpjete + 1;
      }
```

Përgjigje:

```
4 -1
3 0
2 1
```

d.

```
while ( false )
      { System.out.println("false"); }
```

Përgjigje:

Ky kod nuk afishon asgjë.

e.

```
String s = "";
while ( s.length() < 6 )
      { s = s + "a";
        if ( (s.length() % 2) == 1 )
           { System.out.println(s); }
      }
```

Përgjigje:

```
a
aaa
aaaaa
```

2. Shkruaje një cikël-while për t'i afishuar karakterët, prej `'a'` deri në `'z'`, nga një në rresht. (Udhëzim: rikujto se Java të lejon ta inicializosh një ndryshore si `char k = 'a'` dhe të bësh aritmetikë me të, p.sh. `k = k + 1` .)

Përgjigje:

```
char k = 'a'
while ( k <= 'z' )
      { System.out.println(k);
        k = k + 1;
      }
```

3. Shkruaje një cikël-while për t'i afishuar të gjithë plotpjesëtuesit e 1000shit që janë ndërmjet 2 e 50. (Rikujto se një numër i plotë, `i`, e plotpjesëton një tjetër, `j` , nëse `j % i` është 0. Udhëzim: fute një urdhër-if në trupin e ciklit.)

Përgjigje:

```
int n = 2;
while ( n <= 50 )
      { if ( 1000 % n == 0 )
           { System.out.println(n); }
        n = n + 1;
      }
```

7.3 Iterimi Definitiv

1. Implemento një aplikacion që i llogarit mesataret e provimit:

a. Së pari, vendose metodën `llogariteMesataren` në një klasë të re që do ta shkruash, të quajtur `StatistikatEProvimit`. Pastaj shkruaje një metodë `main` me këtë algoritëm:

1. konstrukto një objekt `StatistikatEProvimit`;
2. konstrukto një dialog që kërkon nga shfrytëzuesi ta shkruajë një numër pozitiv për numrin e provimeve
3. thirre metodën `llogariteMesataren` në objektin `StatistikatEProvimit`.
4. konstrukto një dialog që e tregon rezultatin e kthyer nga `llogariteMesataren`.

Përgjigje:

```
import javax.swing.*;
/** StatistikatEProvimit permban metoda
  * per llogaritjen e statistikave te provimit */
public class StatistikatEProvimit
{ public double llogariteMesataren(int sa)
  { ... }

  public static void main(String[] args)
  { StatistikatEProvimit llog = new StatistikatEProvimit();
    String s = JOptionPane.showInputDialog("Shkruaje sasine e provimeve:");
    int sasia = new Integer(s).intValue();
    double mesatarja = llog.llogariteMesataren(sasia);
    JOptionPane.showMessageDialog(null, "Rezultati mesatar: " + mesatarja);
  }
}
```

b. Ndryshoje metodën `llogariteMesataren` ashtu që nëse argumenti i saj është nr. i plotë jopozitiv, metoda tregon një dialog që e shpall një gabim dhe kthen `0.0` si përgjigje.

Përgjigje:

```
double llogariteMesataren(sasia)
{ double pergjigjja = 0.0;
  if ( sasia < 1 )
       { JOptionPane.showMessageDialog(null,
            "Gabim te StatistikatEProvimit: sasia e provimeve - jopozitive)");
       }
  else { double total_pike = 0.0; // totali i krejt pikeve te testeve
         int numri = 0; // numri i testeve te lexuara deri tash
         while ( numri != sasia )
               { String s = JOptionPane.showInputDialog(
                   "Rezultati i provimit + nr. " + (numri + 1) );
                 r = new Integer(s).intValue();
                 total_pike = total_pike + r;
               }
         pergjigjja = total_pike / sa;
       }
  return pergjigjja;
}
```

c. Pastaj, shkruaje një metodë: `llogariteRezultMax`:

```
  /** llogariteRezultMax e lexon nje varg te rezultateve te testeve
    * te dhene nga shfrytezuesi dhe e kthen rezultatin me te larte
    * te lexuar
    * @param sasia - sasia e rezultateve te testeve qe lexohen;
    *                duhet te jete jonegative
    * @return (kthen) rezultatin maksimal */
  public double llogariteRezultMax(int sasia)
```

Shtoja këtë metodë klasës `StatistikatEProvimit` dhe modifikoje metodën `main` (që e shkrove më herët) për ta thirrur `llogariteRezultMax` në vend të `llogariteMesataren`.

Përgjigje:

```
import javax.swing.*;
public class StatistikatEProvimit
{ public int llogariteRezultMax(int sasia)
  { int rezult_max = 0;
    if ( sasia < 1 )
         { JOptionPane.showMessageDialog(null,
             "Gabim te StatistikatEProvimit: sasia e provimeve jopozitive");
         }
    else { int numeruesi = 0;  // sasia e testeve te lexuara deri tash
           while ( numeruesi != sasia )
                  // ne cdo iteracion: rezult_max  e mban maksimumin e
                  //   test_1, test_2, ..., test_numri te lexuara deri tash:
                 { String hyrja = JOptionPane.showInputDialog
                                          ("Shkruaje rezult. e testit tjeter:");
                   int piket = new Integer(hyrja).intValue();
                   if ( piket > rezult_max )
                      { rezult_max = piket; }
                   numeruesi = numeruesi + 1;
                 }
         }
    return rezult_max;
  }

  public static void main(String[] args)
  { StatistikatEProvimit llog = new StatistikatEProvimit();
    String s = JOptionPane.showInputDialog("Numri i provimeve:");
    int sasia_e_pr = new Integer(s).intValue();
    int max = llog.llogariteRezultMax(sasia_e_pr);
    JOptionPane.showMessageDialog(null, "Rezultati me i larte: " + max);
  }
}
```

d. Shkruaje këtë metodë dhe përfshije brenda klasës `StatistikatEProvimeve`:

```
/** llogariteMesatarenPakMeTeMire e llogarit mesataren e rezultateve
  * te testeve te dhena nga shfrytezuesi _por e perjashton_ rezultatin
  * me te ulet ne llogaritje.
  * @param sa - sasia e rezultateve te provimeve qe lexohen;
  *             duhet te jete > 1
  * @return (kthen) mesataren e (sa - 1) rezultateve me te mira */
```

Përgjigje:

```
public double llogariteMesatarenPakMeTeMire(int sa)
{ double pergjigjja = 0.0;
  if ( sa < 1 )
       { JOptionPane.showMessageDialog(null,
           "Gabim te StatistikatEProvimit: sasia e testeve jopozitive");
       }
  else { double total_pike = 0.0;  // totali i krejt pikeve te testeve
         int piket_min = 0;  // piket me te uleta te lexuara deri tash
         int numeruesi = 0;  // sasia e testeve te lexuara deri tash
         while ( numeruesi != sa )
               { String hyrja = JOptionPane.showInputDialog
                                   ("Shkruaje rezult. e testit tjeter:");
                 int piket = new Integer(hyrja).intValue();
                 total_pike = total_pike + piket;
                 // provo mos  piket  jane piket e reja minimale:
                 if ( piket < piket_min  ||  numeruesi == 0 )
                    { piket_min = piket; }
                 count = count + 1;
               }
          pergjigjja = (total_pike - piket_min) / (sa - 1);
        }
  return pergjigjja;
}
```

2. Shkruaje një shteg (gjurmë) të ekzekutimit për këtë shembull:

```
int t = 4;
int numeruesi = 2;
while ( numeruesi <= 4 )
      { t = t * 2;
        numeruesi = numeruesi + 1;
      }
```

Përgjigje:

```
>int t = 4; int numeruesi = 2; while ( numeruesi <= 4 ) { t = t * 2; numeruesi =
numeruesi+1; }

=> int t ==| 4 |
   >int numeruesi = 2; while ( numeruesi <= 4 ) {t = t * 2; numeruesi =
numeruesi+1;}

=> int t ==| 4 |  int numeruesi ==| 2 |
   >while ( numeruesi <= 4 ) { t = t * 2; numeruesi = numeruesi+1; }

=> int t ==| 4 |  int numeruesi ==| 2 |
   >while ( 2 <= 4 ) { t = t * 2; numeruesi = numeruesi+1; }

=> int t ==| 4 |  int numeruesi ==| 2 |
   >while ( true ) { t = t * 2; numeruesi = numeruesi+1; }

=> int t ==| 4 |  int numeruesi ==| 2 |
   while ( true ) { >t = t * 2; numeruesi = numeruesi+1; }
```

```
=> int t ==| 4 |  int numeruesi ==| 2 |
   while ( true ) { >t = 8; numeruesi = numeruesi+1; }

=> int t ==| 8 |  int numeruesi ==| 2 |
   while ( true ) { ... >numeruesi = numeruesi+1; }

=> int t ==| 8 |  int numeruesi ==| 3 |
   while ( true ) { ... > }
```

Në këtë pikë, cikli përsëritet:

```
=> int t ==| 8 |  int numeruesi ==| 3 |
   >while ( numeruesi <= 4 ) { t = t * 2; numeruesi = numeruesi+1; }

=> int t ==| 8 |  int numeruesi ==| 3 |
   >while ( true ) { t = t * 2; numeruesi = numeruesi+1; }

=> int t ==| 8 |  int numeruesi ==| 3 |
   while ( true ) { >t = t * 2; numeruesi = numeruesi+1; }
```

Dy hapa më vonë kemi si vijon:

```
=> int t ==| 16 |  int numeruesi ==| 4 |
   while ( true ) { ... > }

=> int t ==| 16 |  int numeruesi ==| 4 |
   >while ( numeruesi <= 4 ) { t = t * 2; numeruesi = numeruesi+1; }

=> int t ==| 16 |  int numeruesi ==| 4 |
   >while ( true ) { t = t * 2; numeruesi = numeruesi+1; }

=> int t ==| 16 |  int numeruesi ==| 4 |
   while ( true ) { >t = t * 2; numeruesi = numeruesi+1; }

=> int t ==| 32 |  int numeruesi ==| 5 |
   while ( true ) { ... > }
=> int t ==| 32 |  int numeruesi ==| 5 |
   >while ( numeruesi <= 4 ) { t = t * 2; numeruesi = numeruesi+1; }

=> int t ==| 32 |  int numeruesi ==| 5 |
   >while ( false ) { t = t * 2; numeruesi = numeruesi+1; }

=> int t ==| 32 |  int numeruesi  ==| 5 |
    ... >
```

3. Përdore strukturën për iteracion definitiv për ta shkruar një cikël që e afishon këtë dalje, krejt në një rresht: `88 77 66 55 44 33 22 11`

Përgjigje:

```
int nr = 8;
while (nr >= 1)
      { System.out.print("" + nr + nr + " ");
        nr = nr - 1;
      }
System.out.println();
```

ose:

```
int nr = 8;
while ( nr >= 1 )
      // deri tash jane afishuar:  88, 77 ...deri ne... (nr+1)*11
      { System.out.print(nr*11 + " ");
        nr = nr - 1;
      }
System.out.println();
```

4. Shkruaje një metodë `main` që bën si vijon:

a) e përdor një cikël për të kërkuar nga shfrytëzuesi që t'i shkruajë katër fjalë, një nga një, p.sh.

```
Une
e
dua
kompjuterin
```

b) e tregon një dialog që i afishon fjalët të listuara në renditje të kundërt në një rresht, p.sh.

```
kompjuterin dua e Une
```

Përgjigje:

```
import javax.swing.*;
public class Test4
{ public static void main(String[] args)
  { int pika_ndalese = 4;
    int numeruesi = 0;
    String fjalia = "";
    while ( numeruesi != pika_ndalese)
          { String hyrja = JOptionPane.showInputDialog
                           ("Shkruaje nje fjale:");
            fjalia = hyrja + " " + fjalia;
            numeruesi = numeruesi + 1;
          }
    JOptionPane.showMessageDialog(null, fjalia);
  }
}
```

5. Shumë përkufizime standarde matematikore janë llogaritur me cikle të iteracionit definitiv. Për secilin nga përkufizimet që vijojnë, shkruaje një metodë që e llogarit përkufizimin:

a. shuma e një numri të plotë jonegativ, *i*, përkufizohet kështu:

shuma(*i*) = 0 + 1 + 2 + ... + *i*

Për shembull, shuma(4) është 0 + 1 + 2 + 3 + 4 = 10. Pra, shkruaje një metodë që e llogarit shumën, ballina e të cilës duket kështu:

```
public int shuma(int i)
```

Përgjigje:

```
public int shuma(int n)
{ int totali = 0;
  int numeruesi = 0;  // numeron deri ne n
  while ( numeruesi != n )
        // ne secilin iteracion:  totali == 0+1+...deri te...+numeruesi
        { numeruesi = numeruesi + 1;
          totali = totali + numeruesi;
        }
        // totali == 0+1+...deri ne...+n
  return totali;
}
```

b. Prodhimi i iteruar i dy numrave të plotë jonegativë, *a* dhe *b*, është:

prodhimi(*a*, *b*) = *a* * (*a*+1) * (*a*+2) * (*a*+3) * ... * *b*

(Vërejtje: nëse *b* > *a* është e vërtetë, atëherë përkufizo prodhimi(*a*, *b*) = 1.)
Për shembull prodhimi(3, 6) është 3 * 4 * 5 * 6 = 360.

Përgjigje:

```
/** prodhimi  e llogarit prodhimin e iteruar  a*(a+1)*(a+2)*...*b
  * @param  a - numri i plote fillues i prodhimit
  * @param  b - numri i plote mbarues i prodhimit
  * @return  (kthen) a*(a+1)*(a+2)*...*b, nese  a <= b;
  *  return (kthen) 1,  nese a > b   */
public int prodhimi(int a, int b)
{ int totali = 1;
  if ( a <= b )
     { totali = a;
       int numeruesi = a;
       while ( numeruesi != b )
             // totali == a * (a+1) * ...deri ne... * i
             { numeruesi = numeruesi + 1;
               totali = totali * numeruesi;
             }
       // totali == a * (a+1) * (a+2) * ... * b == product(a, b)
     }
  return total;
}
```

c. Një variant i famshëm i prodhimit të iteruar është faktorieli; për një numër jonegativ, *m*, fatorieli, *m*!, përkufizohet si vijon:

0! = 1
n! = 1 * 2 * 3 * ... * *n*, për *n* pozitiv

Për shembull, 5! është 1 * 2 * 3 * 4 * 5 = 120.
(Vërejtje e rëndësishme: Për shkak se vlerat e m! rriten të mëdha shpejt me rritjen e m, përdore Java-tipin e të dhënave `long` ("long integer" - nr. i plotë i gjatë) në vend të `int` për argument dhe përgjigje të këtij funksioni.)

Përgjigje:

```
/** faktoriel  e llogarit n! per n ne rangun 0..20
  * (verejtje: vlerat per n>20 jane shume te medha per llogaritje)
  * @param  n - duhet te jete ne rangun 0..20
  * @return (kthen) n!, nese  n  ne 0.20; perndryshe kthen -1 */
public long faktoriel(int n)
{ long fakt = -1; // fakt - faktorieli
  if ( n >= 0  &&  n <= 20 )
     { int numeruesi = 0;  f = 1;
       while ( numeruesi != n )
             // fakt == 1*2*...deri te...*numeruesi
             { numeruesi = numeruesi + 1;
               fakt = fakt * numeruesi;
             }
       // fakt == faktoriel(n)
     }
  return fakt;
}
```

d. Nëse të pëlqen t'i përdorësh sinusin dhe kosinusin, atëherë përdore metodën faktoriel në ushtrimin e kaluar për t'i implementuar këto metoda klasike:

```
/** sinus e llogarit sinusin e argumentit te vet,
  * duke e perdorur formulen
  * sin(x) = x - (x^3/3!) + (x^5/5!) - (x^7/7!) + ... - (x^19/19!)
  * @param x - vlera, ne radiane, sinusi i te ciles deshirohet
  * (p.sh. sinus(0)=0, sinus(pi/2)=1, sinus(pi)=0, sinus(3pi/2)=-1 etj.)
  * @return (kthen) sinusin e llogaritur nga formula */
public double sinus(double x)
```

(Vërejtje. përdore `Math.pow(a,b)` për të llogaritur a^b.) Krahaso përgjigjet që i jep metoda jote me ato që i jep metoda `Math.sin(...)`.

```
/** kosinus e llogarit kosinusin e vleres se parametrit te vet,
  * duke e perdorur formulen
  * cos(x) = 1 - (x^2/2!) + (x^4/4!) - (x^6/6!) + ... (x^20/20!)
  * @param x - vlera, ne radiane, kosinusi i te ciles deshirohet
  * @return (kthen) kosinusin e llogaritur nga formula
public double kosinus(double x)
```

Përgjigje:

```
public double sinus(double x)
{ double sin = x;
  int numeruesi = 3;
  while ( numumeruesi <= 19 )
        // sin == x - (x^3/3!) +...deri te...(x^(numeruesi-2)/(numeruesi-2)!)
        { double d = Math.pow(x, numeruesi) / factoriel(numeruesi);
          if ( (numeruesi % 4) == 3 )
               { sin = sin - d; }
          else { sin = sin + d; }
          numeruesi = numeruesi + 2;
        }
  return sin;
}
```

(7.3.1 Shembull i Iterimit Definitiv: Vizatimi i Syrit të Demit)

7.4 Divergjenca

1. Shkruaje këtë metodë, që është e dizajnuar që të ekzekutohet përgjithmonë:

```
/** afishoReciproket afishon vlerat decimale te thyesave,
  * 1/2, 1/3, 1/4, ... , nje nga nje: Kur thirret,
  * e tregon nje dialog te mesazhit me informaten, "1/2 = 0.5",
  * dhe kur shfrytezuesi e shtyp OK, e tregon nje tjeter dialog te mesazhit
  * qe thote, "1/3 = 0.3333333333", dhe kur shfrytezuesi e shtyp OK,
  * e tregon edhe nje dialog te mesazhit, "1/4 = 0.25", etj. ...*/
public void afishoReciproket()
```

Përgjigje:

```
public class Test
public static void main(String[] args)
{ int emeruesi = 2;
  while ( true )  // nje menyre e thjeshte qe cikli te punoje pergjithmone
        { double thyesa = 1.0 / emeruesi;
          JOptionPane.showMessageDialog(null,
                          "1/" + emeruesi + " = " + thyesa);
          emeruesi = emeruesi + 1;
        }
}
```

Tash shkruaje një aplikacion që e thirr këtë metodë. Testoje aplikacionin derisa të mërzitesh.

7.5 Iterimi Indefinitiv: Përpunimi i hyrjes

1. Shpjego se çka bën kjo metodë:

```
public static void main(String[] args)
{ boolean duke_perpunuar;
  int totali = 0;
  while ( duke_perpunuar )
        { String s = JOptionPane.showInputDialog("Jepe nje numer te plote:");
          int i = new Integer(s);
          if ( i < 0 )
             { duke_perpunuar = false; }
          else { totali = totali + i; }
        }
  JOptionPane.showMessageDialog(null, totali);
}
```

Përgjigje:

I mbledh disa numra të plotë dhe ndalet kur në hyrje i jipet një numër negativ.

2. Shkruaje një aplikacion që i lexon aq rreshta të tekstit sa don përdoruesi. Përdoruesi i shkruan rreshtat, një nga një, në dialogje hyrëse. Kur përdoruesi e shtyp Cancel ose kur përdoruesi e shtyp vetem tastin Enter (pa tekst të shkruar), programi i afishon në dritaren komanduese të gjithë rreshtat që i ka shkruar përdoruesi dhe ndalet. (Udhëzim: Mund t'i ruash rreshtat e plotë të tekstit në një ndryshore `String` si vijon:

```
String s = "";
...
s = s + nje_rresht_i_tekstit + "\n";
```

Rikujto se `'\n'` është karakteri për rresht të ri.

Përgjigje:

```
public static void main(String[] args)
{ String teksti = "";
  boolean duke_perpunuar = true;
  while ( duke_perpunuar )
        { String hyrja = JOptionPane.showInputDialog("Shkruaj ca tekst:");
          if ( hyrja == null          // a u shtyp Cancel?
             || hyrja.equals("") )    // a eshte futur rresht i zbrazet?
                                      // (vetem Enter)
               { duke_perpunuar = false; }
          else { teksti = teksti + hyrja + "\n"; }
        }
  System.out.println(teksti);
}
```

3. Rishkruaje menaxherin e kontove të bankës nga kapitulli 6 ashtu që të përdorë cikël-while për transakcionet e veta hyrëse.
(Udhëzim: Rishkruaje `perpunoTransaksionet (processTransactions)` në klasën `KontrolluesILlogarise (AccountController)` në Figurën 16, Kapitulli 6.)

Përgjigje:

Metoda `perpunoTransaksionet` tani duket kështu:

```
...
  /** perpunoTransaksionet i perpunon komandat e perdoruesit derisa te jepet Q*/
  public void perpunoTransaksionet()
  { boolean duke_perpunuar = true;
    while ( duke_perpunuar )
          // deri tash, te gjitha transaksionet jane perpunuar korrektesisht
          { char komanda = lexuesi.lexoKomanden("Komanda (D,T,Q) dhe sasia:");
            if ( komanda == 'Q' )  // sinjali per t'u ndalur
                 { duke_perpunuar = false; }
            else if ( komanda == 'D' )  // depozitim ?
                      { ... shih Figuren 12, Kapitulli 6 ne liber... }
                   else if ( komanda == 'T' )  // terheqje?
                      { ... shih Figuren 12, Kapitulli 6 ne liber... }
                   else { shkruesi.tregoTransaksionin("Komande e parregullt"); }

          }
  }
}
```

7.6 Urdhëri `for`

1. Rishkruaje metodën `llogariteMesataren` në Figurën 1 ashtu që të përdorë urdhër-for.

Përgjigje:

```
public double llogariteMesataren(int sa)
{ double total_pike = 0.0;  // totali i te gjitha pikeve
  int numri = 0;  // sasia e testeve te lexuara deri tash
  for ( int numri = 0;  numri != sa;  numri = numri + 1 )
      // ne cdo iteracion: total_pike == prov_1 + prov_2 + ... + prov_numri
      { String hyrja = JOptionPane.showInputDialog("Piket e prov. tjeter:");
        int piket = new Integer(hyrja).intValue();
        total_pike = total_pike + piket;
        System.out.println("numri = " + numri + "; totali = " + total_pike);
      }
  return (total_pike / sa);
}
```

2. Përdore një urdhër-for për ta shkruar një funksion, `'ktheje'`, që e pranon një parametër string, `s`, dhe e kthen si rezultat të vetin stringun që duket si `s` e kthyer mbrapsht, p.sh. `ktheje("abcd")` kthen `"dcba"`.

Përgjigje:

```
/** ktheje e kthen mbrapsht nje argument string
  * @param s - stringu qe do te kthehet
  * @return (kthen) stringun e kthyer mbrapsht,
  *         p.sh. kthen "cba" kur  s  eshte "abc" */
public String ktheje(String s)
{ String pergjigjja = "";
  for ( int i = 0;  i != s.length();  i = i+1 )
      // invariant: pergjigjja i mban  i  karakteret e pare te  s
      // ne renditje te kundert
      { pergjigjja = s.charAt(i) + pergjigjja; }
  return pergjigjja;
}
```

3. Rishkruaje metodën në Figurën 2 që ta përdorë një urdhër-for.

4. Ciklet-while që i ke shkruar në përgjigjet e ushtrimeve te "Iterimi definitiv" - tash rishkruaji si cikle-for.

7.7 Ciklet e Ndërfutura

1. Shkruaji ciklet e ndërfutura që e japin tabelën e mbledhjes për 0+0 deri në 5+5.

Përgjigje:

```
for (int i = 0; i <= 5; i = i + 1 )
    { for ( int j = 0; j <= 5; j = j + 1 )
          { System.out.print(i + "+" + j + "=" + (i+j) + " "); }
      System.out.prinln();
    }
```

2. Shkruaje këtë metodë:

```
/** hiqiShkronjatEDyfishta e konstrukton nje string qe i përmban
  * shkronjat e njejta si argumenti i vet, por te gjitha shkronjat
  * e dyfishta (duplikatet) hiqen,
  * p.sh., per argument "fluturat", rezultati eshte "flutra"
  * @param s - stringu argument
  * @return (kthen) nje string qe duket si s por pa duplikate
public String hiqiShkronjatEDyfishta(String s)
```

Përgjigje:

Cikli i ndërfutur gjendet në metodën ndihmëse, `nukGjendetNe`:

```
/** hiqiShkronjatEDyfishta e konstrukton nje string qe i permban
  * shkronjat e njejta si argumenti i vet, por te gjitha shkronjat
  * e dyfishta (duplikatet) hiqen,
  * p.sh., per argument "fluturat", rezultati eshte "flutra"
  * @param s - stringu argument
  * @return (kthen) nje string qe duket si s por pa duplikate
public String hiqiShkronjatEDyfishta(String s)
{ String pergjigjja = "";
  for ( int i = 0; i != s.length(); i = i + 1 )
      // invariant: pergjigjja e mban saktesisht nga nje kopje
      // te cdo karakteri qe paraqitet ne nenstringun
      // s.charAt(0) ..deri ne.. s.charAt(i-1)
      { if ( nukGjendetNe(pergjigjja, s.charAt(i)) )
           { pergjigjja = pergjigjja + s.charAt(i); }
      }
  return pergjigjja;
}

/** nukGjendetNe(String a, char c)
{ boolean nukgjendet = true;
  for ( int j = 0; j != a.length(); j = j + 1 )
      // invariant: nukgjendet tregon se a mungon c
      // ne nenstringun a.charAt(0)..deri ne.. a.charAt(j-1)
      { nukgjendet = nukgjendet && (c != a.charAt(j)); }
  return nukgjendet;
}
```

3. Shkruaji ciklet e ndërfutura që e afishojnë këtë model:

```
0 0
1 0   1 1
2 0   2 1   2 2
3 0   3 1   3 2   3 3
```

Përgjigje:

```
for ( int i = 0; i <= 3; i = i + 1 )
      for ( int j = 0; j <= i; j = j + 1 )
          { System.out.print(i + " " + j); }
        System.out.println();
    }
```

4. Shkruaji ciklet e ndërfutura që e afishojnë këtë model:

```
0 3   0 2   0 1   0 0
1 3   1 2   0 1
2 3   2 2
3 3
```

Përgjigje:

```
for ( int i = 0; i <= 3; i = i + 1 )
    { for ( j = 3; j >= i; j = j + 1 )
          { System.out.print(i + " " + j + "   "); }
      System.out.println();
    }
```

(7.8 Shkruarja dhe Testimi i Cikleve)

7.9 Case Study: Animim i Topave Kërcyes

Qe klasët e animimit:

```
// Fajli TopLevizes.java

/** TopLevizes e modelon nje top qe leviz */
public class TopLevizes
{ private int x_poz;  // x-pozita e qendres se topit
  private int y_poz;// y-pozita e qendres se topit
  private int rrezja;  // rrezja e topit

  private int x_shpejtesia = +5;  // shpejtesia horizontale; pozitive = djathtas
  private int y_shpejtesia = +2;  // shpejtesia vertikale; pozitive = teposhte

  private Kuti mbajtesi;      // mbajtesi ne te cilin udheton topi

  /** Konstruktori TopLevizes e konstrukton topin.
    * @param x_fillues - qendra horizontale e pozites filluese te topit
    * @param y_fillues - qendra vertikale e pozites filluese te topit
    * @param r - rrezja e topit
    * @param kutia - permbajetesi ne te cilin udheton topi */
  public TopLevizes(int x_fillues, int y_fillues, int r, Kuti kutia)
  { x_poz = x_fillues;
    y_poz = y_fillues;
    rrezja = r;
    mbajtesi = kutia;
  }

  /** xPozita e kthen poziten horizontale momentale te topit */
  public int xPozita()
  { return x_poz; }

  /** yPozita e kthen poziten vertikale momentale te topit */
  public int yPozita()
  { return y_poz; }

  /** rrezjaE e kthen rrezen e topit */
  public int rrezjaE()
  { return rrezja; }

  /** levize e leviz topin
    * @param njesi_kohe - sasia e kohes prejse eshte levizur topi
    *                     heren e fundit */
  public void leviz(int njesi_kohe)
  { x_poz = x_poz + (x_shpejtesia * njesi_kohe);
    if ( mbajtesi.neKontaktHorizontal(x_poz) )
       { x_shpejtesia = -x_shpejtesia; } // ktheje drejtimin horizontal prapa
    y_poz = y_poz + (y_shpejtesia * njesi_kohe);
    if ( mbajtesi.neKontaktHorizontal(y_poz) )
       { y_shpejtesia = -y_shpejtesia; } // ktheje drejtimin vertikal prapa
  }

  // vazhdon ne faqen tjeter...
```

```
  //...vazhdon nga faqja e përparshme

  public static void main(String[] args)
  { Kuti kutia = new Kuti(50); // me madhesi 50 piksela me 50 piksela
    TopLevizes topi = new TopLevizes(25, 25, 10, kutia); // rrezja = 10 piksela
    while ( true )
          { topi.leviz(1); // 1 njesi te kohes se kaluar
            System.out.println("x = " + topi.xPozita()
              + "; y = " + topi.yPozita());
          }
  }
}

------------------------------

// Fajli Kuti.java

/** Kuti e modelon nje kuti ne te cilen jetojne objektet levizese */
public class Kuti
{ private int madhesia_e_kutise;

  /** Konstruktori Kuti e nderton kutine
    * param madhesia - madhesia e kutise */
  public Kuti(int madhesia)
  { madhesia_e_kutise = madhesia; }

  /** neKontaktHorizontal pergjigjjet:
    *  a ka kontaktuar pozita momentale ndonje mur horizontal?
    * @param x_pozita - pozita qe testohet
    * @return (kthen) true, nese x_pozita eshte baraz ose i kalon pozitat
    * e mureve horizontale; perndryshe return (kthen) false */
  public boolean neKontaktHorizontal(int x_pozita)
  { return ( x_pozita <= 0 ) || (x_pozita >= madhesia_e_kutise); }

  /** neKontaktVertikal pergjigjet: a ka kontaktuar pozita ndonje mur vertikal
    * @param y_pozita - pozita e testuar
    * return (kthen) true, nese y_pozita eshte baraz ose i tejkalon pozitat
    *   e mureve vertikale; perndryshe, return (kthen) false */
  public boolean neKontaktVertikal(int y_pozita)
  { return (y_pozita <= 0) || (y_pozita >= madhesia_e_kutise); }

  /** madhesiaE e kthen madhesine e kutise */
  public int madhesiaE()
  { return madhesia_e_kutise; }
}
```

```
// Fajli VizatuesAnimacioni.java

import java.awt.*;
import javax.swing.*;
/** VizatuesAnimacioni e paraqet nje kuti me nje top ne te. */
public class VizatuesAnimacioni extends JPanel
{ private VizatuesKutie vizatuesi_i_kutise; // pamja dalese e kutise
  private VizatuesTopi vizatuesi_i_topit;   // pamja dalese e topit ne kuti

  /** Konstruktori VizatuesAnimacioni e konstrukton pamjen e kutise dhe te topit
    * @param k - vizatuesi i kutise
    * @param t - vizatuesi i topit
    * @param madhesia - madhesia e kornizes */
  public VizatuesAnimacioni(VizatuesKutie k, VizatuesTopi t, int madhesia)
  { vizatuesi_i_kutise = k;
    vizatuesi_i_topit = t;
    JFrame korniza_ime = new JFrame();
    korniza_ime.getContentPane().add(this);
    korniza_ime.setTitle("Gjuajtja e Topit");
    korniza_ime.setSize(madhesia, madhesia);
    korniza_ime.setVisible(true);
  }

  /** paintComponent paints the box and ball
    * @param g - the graphics pen */
  public void paintComponent(Graphics g)
  { vizatuesi_i_kutise.vizato(g);
    vizatuesi_i_topit.vizato(g);
  }

  /** main - vetem per testim */
  public static void main(String[] args)
  { Kuti k = new Kuti(200);
    TopLevizes t = new TopLevizes(50, 50, 10, k);
    VizatuesKutie vk = new VizatuesKutie(k);
    VizatuesTopi vt = new VizatuesTopi(t, Color.red);
    new VizatuesAnimacioni(vk, vt, 50);
  }
}
```

```
// Fajli VizatuesKutie.java

import java.awt.*;
/** VizatuesKutie e paraqet nje kuti */
public class VizatuesKutie
{ private Kuti kutia; // objekti kuti qe do te paraqitet

  /** Konstruktori VizatuesKutie e paraqet kutine
    * @param k - kutia qe paraqitet */
  public VizatuesKutie(Kuti k)
  { kutia = k; }

  /** vizato e vizaton kutine
    * @param g - the penda grafike e perdorur per ta vizatuar kutine */
  public void vizato(Graphics g)
  { int madhesia = kutia.madhesiaE();
    g.setColor(Color.white);
    g.fillRect(0, 0, madhesia, madhesia);
    g.setColor(Color.black);
    g.drawRect(0, 0, madhesia, madhesia);
  }
}

-------------------------------------------

// Fajli VizatuesTopi.java

import java.awt.*;
/** VizatuesTopi e paraqet ne ekran nje top levizes */
public class VizatuesTopi
{ private TopLevizes topi; // objekti top i paraqitur (adresa e vet)
  private Color ngjyra_e_topit;

  /** Konstruktori VizatuesTopi
    * @param x - topi qe do te paraqitet
    * @param n - ngjyra e tij */
  public VizatuesTopi(TopLevizes x, Color n)
  { topi = x;
    ngjyra_e_topit = n;
  }

  /** vizato e vizaton topin ne pamje (ekran)
    * @param g - penda grafike e perdorur per ta vizatuar topin */
  public void vizato(Graphics g)
  { g.setColor(ngjyra_e_topit);
    int rrezja = topi.rrezjaE();
    g.fillOval(topi.xPozita() - rrezja, topi.yPozita() - rrezja,
               rrezja * 2, rrezja * 2);
  }
}
```

```
// Fajli GjuajtjeKontrollues.java

/** GjuajtjeKontrollues e kontrollon nje top levizes brenda nje kutie. */
public class GjuajtjeKontrollues
{ private TopLevizes topi; // objekti model
  private VizatuesAnimacioni vizatuesi; // objekti i pamjes-dalese

  /** Konstruktori GjuajtjeKontrollues e nis kontrolluesin
    * @param t - objekti model
    * @param v - objekti i pamjes dalese */
  public GjuajtjeKontrollues(TopLevizes t, VizatuesAnimacioni v)
  { topi = t;
    vizatuesi = v;
  }

  /** niseAnimacionin e nis animacionin sipas ores se brendshme */
  public void niseAnimacionin()
  { int njesia_e_kohes = 1; // njesia e kohes per secilin hap te animacionit
    int vonesa_e_vizatimit = 20; // sa te vonohet ndermjet dy rivizatimeve
    while ( true )
    { prit(vonesa_e_vizatimit);
      topi.leviz(njesia_e_kohes);
      System.out.println(topi.xPozita() + ", " + topi.yPozita());
      vizatuesi.repaint(); // rishfaqe kutine dhe topin
    }
  }

  /** prit e ndal ekzekutimin per 'sa' milisekonda */
  private void prit(int sa)
  { try { Thread.sleep(sa); }
    catch (InterruptedException e) { }
  }
}

-----------------------------------

// Fajli GjuajeTopin.java

import java.awt.*;
/** GjuajeTopin i konstrukton dhe i nis objektet e animacionit. */
public class GjuajeTopin
{ public static void main(String[] args)
  { // konstrukto objektet e modelit:
    int madhesia_e_kutise = 200;
    int rrezja_e_topit = 6;
    Kuti kutia = new Kuti(madhesia_e_kutise);
    // vendose topin jo mu ne qender te kutise, po afer 3/5 e pozites:
    TopLevizes topi = new TopLevizes((int)(madhesia_e_kutise / 3.0),
                                     (int)(madhesia_e_kutise / 5.0),
                                     rrezja_e_topit, kutia);
    VizatuesTopi vizatuesi_i_topit = new VizatuesTopi(topi, Color.red);
    VizatuesKutie vizatuesi_i_kutise = new VizatuesKutie(kutia);
    VizatuesAnimacioni vizatuesi
            = new VizatuesAnimacioni(vizatuesi_i_kutise, vizatuesi_i_topit,
                                     madhesia_e_kutise);
    // konstruktoje kontrolluesin dhe nise:
    new GjuajtjeKontrollues(topi, vizatuesi).niseAnimacionin();
  }
}
```

1. Ekzekutoje animimin e topave kërcyes. Nganjëherë, do ta vëreni se si topi kthehet nga muri "shumë vonë", dmth. topi e ndërron drejtimin pasi të hyjë në mur. Gjeje burimin e këtij problemi dhe jep mënyra se si të rregullohet animacioni.

Përgjigje:

Metoda `leviz` brenda klasës `TopLevizes` së pari e lëviz topin, e pastaj e kontrollon pozitën e topit. Kështu, topi mund t'i depërtojë muret e kutisë. Për ta parandaluar këtë, `'leviz'` duhet ta kontrollojë pozitën e topit para se ta lëvizë topin dhe, nëse është e nevojshme, ta lëvizë topin pikërisht afër murit, dhe jo më tej.

2. Rregulloje animacionin e topit kërcyes ashtu që të jenë dy topa në kuti.
(Mos u brengos për përplasjen e dy topave.)

Përgjigje:

Për ta bërë animacionin me dy topa, krijo dy objekte `TopLevizes` dhe futi në kuti.
Qe ku janë klasët që i marrin ndërrimet e thjeshta:

```
import java.awt.*;
/** GjuajeTopin i konstrukton dhe i nis objektet ne animacion. */
public class GjuajeTopin2
{ public static void main(String[] args)
  { // konstrukto objektet e modelit:
    int madhesia_e_kutise = 200;
    int rrezja_e_topit = 6;
    Kuti kutia = new Kuti(madhesia_e_kutise);
    TopLevizes topi1 = new TopLevizes((int)(madhesia_e_kutise / 2.0),
                                      (int)(madhesia_e_kutise / 5.0),
                                       rrezja_e_topit, kutia);
    TopLevizes topi2 = new TopLevizes((int)(madhesia_e_kutise / 5.0),
                                      (int)(madhesia_e_kutise / 2.0),
                                       rrezja_e_topit, kutia);

    // konstrukto objektet e pamjes dalese:
    VizatuesTopi vizatuesi_i_topit1 = new VizatuesTopi(topi1, Color.red);
    VizatuesKutie vizatuesi_i_kutise = new VizatuesKutie(kutia);
    VizatuesTopi vizatuesi_i_topit2 = new VizatuesTopi(topi2, Color.blue);

    VizatuesAnimacioni2 vizatuesi
             = new VizatuesAnimacioni2(vizatuesi_i_kutise,
                                       vizatuesi_i_topit1, vizatuesi_i_topit2,
                                       madhesia_e_kutise);
    // konstruktoje kontrolluesin dhe nise:
    new GjuajtjeKontrollues2(topi1, topi2, vizatuesi).niseAnimacionin();
  }
}
```

```
import java.awt.*;
import javax.swing.*;
/** VizatuesAnimacioni2 e paraqet nje kuti me dy topa ne te. */
public class VizatuesAnimacioni2 extends JPanel
{ private VizatuesKutie vizatuesi_i_kutise;  // pamja dalese e kutise
  private VizatuesTopi vizatuesi_i_topit1;   // pamja dalese e topit1 ne kuti
  private VizatuesTopi vizatuesi_i_topit2;   // pamja dalese e topit2 ne kuti

  /** Konstruktori VizatuesAnimacioni e konstrukton pamjen e kutise dhe topit
    * @param k - vizatuesi i kutise
    * @param t1 - vizatuesi i topit te pare
    * @param t2 - vizatuesi i topit te dyte
    * @param madhesia - madhesia e kornizes */
  public VizatuesAnimacioni2(VizatuesKutie k,
                             VizatuesTopi t1,
                             VizatuesTopi t2,
                             int madhesia)
  { vizatuesi_i_kutise = k;
    vizatuesi_i_topit1 = t1;
    vizatuesi_i_topit2 = t2;
    JFrame korniza_ime = new JFrame();
    korniza_ime.getContentPane().add(this);
    korniza_ime.setTitle("Gjuaje");
    korniza_ime.setSize(madhesia, madhesia);
    korniza_ime.setVisible(true);
  }

  /** paintComponent paints the box and ball
    * @param g - the graphics pen */
  public void paintComponent(Graphics g)
  { vizatuesi_i_kutise.vizato(g);
    vizatuesi_i_topit1.vizato(g);
    vizatuesi_i_topit2.vizato(g);
  }

  /** main - vetem per testim */
  public static void main(String[] args)
  { Kuti k = new Kuti(200);
    TopLevizes t = new TopLevizes(50, 50, 10, k);
    VizatuesKutie vk = new VizatuesKutie(k);
    VizatuesTopi vt = new VizatuesTopi(t, Color.red);
    new VizatuesAnimacioni(vk, vt, 50);
  }
}
```

```
/** GjuajtjeKontrollues i kontrollon dy topa levizes brenda nje kutie. */
public class GjuajtjeKontrollues2
{ private TopLevizes topi1; // objekt model
  private TopLevizes topi2; // objekt model
  private VizatuesAnimacioni2 vizatuesi; // objekti i pamjes-dalese

  /** Konstruktori GjuajtjeKontrollues e nis kontrolluesin
    * @param t1 - top
    * @param t2 - top tjeter
    * @param v - objekti i pamjes dalese */
  public GjuajtjeKontrollues2(TopLevizes t1, TopLevizes t2,
                              VizatuesAnimacioni2 v)
  { topi1 = t1;
    topi2 = t2;
    vizatuesi = v;
  }

  /** niseAnimacionin e nis animacionin sipas ores se brendshme */
  public void niseAnimacionin()
  { int njesia_e_kohes = 1; // njesia e kohes per secilin hap te animacionit
    int vonesa_e_vizatimit = 20; // sa te vonohet ndermjet dy rivizatimeve
    while ( true )
    { prit(vonesa_e_vizatimit);
      topi1.leviz(njesia_e_kohes);
      topi2.leviz(njesia_e_kohes);
      // System.out.println(topi.xPozita() + ", " + topi.yPozita());
      vizatuesi.repaint(); // rishfaqe kutine dhe topin
    }
  }

  /** prit e ndal ekzekutimin per 'sa' milisekonda */
  private void prit(int sa)
  { try { Thread.sleep(sa); }
    catch (InterruptedException e) { }
  }
}
```

3. Nëse e ke kryer ushtrimin e kaluar, ripunoje animacionin ashtu që përplasja e dy topave të shkaktojë që të dy topat t'i kthejnë mbrapsht drejtimet horizontale dhe vertikale.

4. Vendose një pengesë të vogël në qendër të kutisë ashtu që topat të refuzohen nga pengesa.

(7.10 Rekursioni)

7.11 Numërimi me Rekursion

1. Shkruaje një aplikacion që i afishon vlerat e 3!, 6!, 9!, ... , 18! .

Përgjigje:

```
public class TestFaktoriel
{
  public static void main(String[] args)
  { for ( int i = 3;  i <= 20;  i = i+3 )
    // invariant: jane afishuar faktorialet prej 3 ..deri ne.. (i-1)
    { System.out.println( i + "! = " +  faktoriel(i) ); }
  }

  public static long faktoriel(int n)
  { ... }
}
```

2. Largoje nga metoda `'faktoriel'` urdhërin e parë kushtëzues, atë që e teston `n<0 || n>20`. Pastaj provo ta llogaritësh `faktoriel(20)`, `faktoriel(21)`, `faktoriel(99)`, dhe `faktoriel(-1)`.

Përgjigje:

Do ta marrësh këtë dalje:

```
20! = 2432902008176640000
21! = -4249290049419214848
99! = 0
Exception in thread "main" java.lang.StackOverflowError
        at TestFactorial.factorial(Compiled Code)
        at TestFactorial.factorial(Compiled Code)
         ...
```

Përgjigjja për 21! është qartas jokorrekte dhe paraqitet për shkak se ndryshoret `long` mbajnë numra prej rreth 20 shifrash të shumtën. Kur futet një numër më i madh, paraqitet teprimi (overflow) dhe disa shifra të rëndësishme të numrit cungohen (hiqen). (Në shembullin e mësipërm, përgjigjja e gjymtuar duket si numër negativ.) Një shembull edhe më ekstrem i këtij fenomeni ndodh te 99! Përfundimisht, tentimi për të llogaritur -1! shkakton një sasi të pakufizuar të thirrjeve rekursive, që e mbush plotësisht memorjen e kompjuterit me kopje të papërfunduara të `'faktoriel'`-it. Kjo shkakton gabim: `StackOverflowError`.

3. Me pak të menduar, mund ta përdorësh një cikël-while për t'i programuar barazimet rekurzive për faktoriel. Bëje këtë.

Përgjigje: Shih përgjigjen në ushtrimin 5 në njësinë "Iterimi definitiv".

4. Implemento Funksionin e Fibonaçit me një metodë që i përmban dy rekursione, dhe provoje funksionin tënd me parametra të vërtetë (aktualë) 20; 30; 35; 40. Pse llogaritja shkon aq ngadalë për këto raste të testimit?
(Meqë ra fjala, Funksioni i Fibonaçit ishte propozuar në shekullin e 13-të për t'i numëruar numrin e çifteve të lepujve të prodhuar nga një çift fillestar, duke supozuar se një çift i lepujve vonohet një muaj të piqet dhe prej atëherë e tutje çifti prodhon nga një çift të lepujve çdo muaj!)

Përgjigje:

```
/** fibonacci  e llogarit funksionin fibonacci */
public static int fibonacci(int n)
{ int pergjigjja;
  if ( n == 0  ||  n == 1 )
       { pergjigjja = 1; }
  else { pergjigjja = fibonacci(n-1) + fibonacci(n-2); }
  System.out.println("fibonacci(" + n + ") = " + pergjigjja);
  return pergjigjja;
}
```

Mund të llogarisim dhe të shohim se fibonacci(20) është 10946, fibonacci(30) është 1346269, fibonacci(35) është 14930352, dhe fibonacci(40) është 165580141. Këta nuk janë numra të mëdhenj, por llogaritja shkon ngadalë sepse funksioni rregullisht i rillogarit përgjigjet e njëjta. (Urdhëri System.out.println në metodë do ta tregojë këtë qartas!) Për shembull, fibonacci(20) dërgon mesazhe për llogaritjen e fibonacci(19) dhe fibonacci(18), pastaj fibonacci(19) dërgon mesazhe për t'u llogaritur fibonacci(18) dhe fibonacci(17), edhe pse fibonacci(18) tashmë është duke u llogaritur. Këto rillogaritje eksplodojnë derisa parametrat e vërtetë (aktualë) zvogëlohen në vlerë.
Në kapitullin tjetër mësojmë si t'i përdorim *vargjet* për t'iu ikur llogaritjeve të tepërta.

5. Qe një algoritëm rekursiv për ta llogaritur prodhimin e një vargu të numrave të plotë jonegativë:

```
prodhimi(a, b) = 1, kur b < a
prodhimi(a, b) = prodhimi(a, b-1) * b, kur b >= a
```

Shkruaje një metodë të përkufizuar në mënyrë rekursive që e llogarit prodhimin.

Përgjigje:

```
/** prodhimi e llogarit prodhimin a*(a+1)*(a+2)*...*b
  * @param  a - numri i plote fillues pwr prodhimin
  * @param  b - numri i plotw mbarues pwr prodhimin
  * @return (kthen) a*(a+1)*(a+2)*...*b, nese  a <= b;
  *  return (kthen) 1,  nese  a > b   */
public int prodhimi(int a, int b)
{ int totali;
  if ( b < a )
       { totali = 1; }
  else { totali = prodhimi(a, b-1) * b; }
  return totali;
}
```

Krahasoje këtë zgjidhje me atë të Ushtrimit 5 në pjesën "Iterimi definitiv".

6. Edhe një aktivitet i thjeshtë si mbledhja e dy numrave të plotë jonegativë mund të zgjidhet në mënyrë rekursive vetëm sipas "-1" dhe "+1":

```
mbledh(0, b) = b
mbledh(a, b) = mbledh(a-1, b) + 1, kur a > 0
```

a. Shkruaje një metodë të përkufizuar në mënyrë rekursive që e llogarit këtë përkufizim.
b. Në stil të ngjashëm, përkufizoje shumëzimin, `'shumëzo'`, të dy numrave të plotë jonegativë sipas "-1" dhe `'mbledh'`.
c. Përkufizoje fuqizimin, `'fuqi'`, të dy numrave të plotë jonegaticvë sipas "-1" dhe `'shumezo'`.

Përgjigje:

```
/** mbledh e llogarit a + b, per numrat jonegative  a dhe b  */
public int mbledh(int a, int b)
{ int rezultati;
  if ( a == 0 )
       { rezultati = b; }
  else { rezultati = mbledh(a-1, b) + 1; }
  return rezultati;
}

/** shumezo e llogarit a * b, per numrat jonegative  a dhe b  */
public int shumezo(int a, int b)
{ int rezultati;
  if ( a == 0 )
       { rezultati = 0; }
  else { rezultati = mbledh(shumezo(a-1, b), b); }
  return rezultati;
}

/** fuqi e llogarit  a^b, per numrat jonegative  a dhe b  */
public int fuqi(int a, int b)
{ int rezultati;
  if ( b == 0 )
       { rezultati = 1; }
  else { rezultati = shumezo(a, fuqi(a, b-1)); }
  return rezultati;
}
```

7. Funksioni i Akermanit është edhe një përkufizim i famshëm rekursiv:

```
A(0, n) = n + 1
A(m, 0) = A(m-1, 1), kur m>0
A(m, n) = A(m-1, A(m, n-1)), kur m > 0 dhe n > 0
```

Shkruaje një metodë të përkufizuar në mënyrë rekursive mbi këtë përkufizim. Funksioni është i famshëm sepse rekursionet e tij shkaktojnë që vlerat e parametrit të dytë të rriten derisa parametri i parë zvogëlohet ngadalë, por megjithatë funksioni kryhet gjithmonë.

Përgjigje:

```
public static int ackermann(int m, int n)
{ int rezultati;
  if ( m == 0 )
       { rezultati = n+1; }
  else if ( n == 0 )
       { rezultati = ackermann(m-1, 1); }
  else { rezultati = ackermann(m-1, ackermann(m, n-1)); }
  System.out.println("ackermann(" + m + ", " + n + ") = " + rezultati);
  return rezultati;
}
```

Provoje këtë metodë në shembuj të vegjël së pari, p.sh., `ackermann(2, 2)`. Pastaj, përdore orën tënde për ta matur se sa kohë po i duhet kompjuterit tënd që ta llogarisë `ackermann(3, 5)`.

8. Themi se një fjalë është *e sortuar* nëse të gjitha shkronjat e saj janë të ndryshme dhe janë të renduara në radhitje alfabetike, p.sh. "bdez" është e sortuar por "ba" dhe "bbd" nuk janë. Shkruaje një algoritëm rekursiv që e llogarit numrin e fjalëve të sortuara të gjatësisë n ose më të vogël që dikush mund t'i krijojë nga n shkronja të ndryshme.

Përgjigje:

```
numri_i_fjaleve_te_sortuara(1) = 1
```

Një shkronjë e vetme është fjalë e sortuar.

```
numri_i_fjaleve_te_sortuara(n) = q + 1 + q,
   ku q = numri_i_fjaleve_te_sortuara(n-1)
```

Qe arsyetimi: E zëmë se i kemi shkruar q fjalë të ndryshme të sortuara me n-1 shkronja të ndryshme, dhe e zëmë se '*z*' është shkronjë e re që është e ndryshme nga të gjitha shkronjat e përdorura deri tash. Fjalët e sortuara që mund t'i shkruajmë tash përfshijnë *(i)* ato që tashmë i kemi shkruar; *(ii)* '*z*' vetëm; *(iii)* të gjitha fjalët e reja të sortuara që mund t'i ndërtojmë nga fjalët e vjetra të sortuara plus '*z*'. Në rastin e fundit, janë saktësisht q fjalë të tilla të sortuara, që konstruktohen duke e futur '*z*' në pozitën e vet të duhur brenda secilës fjalë të sortuar më parë.

7.12 Vizatimi i Figurave Rekursive

1. Rishkruaje klasën `VizatuesRekursivFigurash` duke e hequr kufirin përreth secilës figurë; pastaj, lëvizi vezët ashtu që ato të rrinë në këndin e majtë të figurës, e jo në të djathtin.

Përgjigje:

Ripunoje metodën `vizatojeFiguren`:

```
  private void vizatojeFiguren(int kufiri_djathtas, int poshte,
                               int madhesia_e_vezes,
                               Graphics g)
  { int madhesia_e_vezes_prapa = (int)(madhesia_e_vezes * SHKALLA);
    if ( madhesia_e_vezes_prapa > 0 )  // a ia vlen te vizatohet prapavija
       { vizatojeFiguren((int)(kufiri_djathtas * SHKALLA),
                         (int)(poshte * SHKALLA),
                         madhesia_e_vezes_prapa,
                         g);
       }
    // vizatoje nje veze perpara
    vizatojeNjeVeze(0, poshte, madhesia_e_vezes, g);
  }
```

2. Shkruaje një klasë që e krijon një rreth me diametër prej 200 pikselash, në të cilin është një tjetër rreth sa 0.8 e madhësisë së të parit, në të cilin është një rreth tjetër sa 0.8 e madhësisë së të dytit, ..., derisa rrethi zvogëlohet në madhësinë 0.

Përgjigje:

```
import java.awt.*;
import javax.swing.*;
/** VizatuesIRratheve e vizaton nje koleksion te rratheve bashkeqendrore  */
public class VizatuesIRratheve extends JPanel
{ private double SHKALLA = 0.8;  // madhesia e figures prapa ne relacion
                                 // me figuren perpara
  private int GJERESIA = 300;
  private int DIAMETRI = 200;

  /** Konstruktori VizatuesIRratheve e krijon dritaren */
  public VizatuesIRratheve()
  { JFrame korniza_ime = new JFrame();
    korniza_ime.getContentPane().add(this);
    korniza_ime.setTitle("Rrathet");
    korniza_ime.setSize(GJERESIA, GJERESIA);
    korniza_ime.setBackground(Color.white);
    korniza_ime.setVisible(true);
  }
```

```
  /** paintComponent i vizaton rrathet
    * @param g - ''penda grafike'' */
  public void paintComponent(Graphics g)
  { vizatoRrathet(DIAMETRI, g); }

  private void vizatoRrathet(int madhesia, Graphics g)
  { if ( madhesia > 0 )
       { int pozita_e_kendit = (GJERESIA / 2) - (madhesia / 2);
         g.drawOval(pozita_e_kendit, pozita_e_kendit, madhesia, madhesia);
         vizatoRrathet((int)(madhesia * 0.8), g);
       }
  }

